

Hospitalizimi i pavullnetshëm – disa çështje etike, legale dhe humane

Sh.Mecinaj,O.Veliu,H.Fazliu,V.Tafilaj,B.Kadriu, L.Halili

Abstrakt : çdo vit në Klinikën e Psikiatrisë hospitalizohen rreth 250 klient, pa vullnetin e tyre. Manifestimi psiko-patologjik, urdhërat e gjykatave si dhe rrethanat tjera “detyrojnë” mjekët kujdestarë në zyrën e pranimit për të marrë vendime për hospitalizim të pavullnetshëm.

Qëllimi : i këtij punimi është që të shihet se si është vepruar lidhur me trajtimin e pavullnetshëm të klientëve deri në fund të vitit 2015 , kur është aprovuar Ligji për Shëndet Mendor. Poashtu për sfidat rreth fillimit të imlementimit të të njëjtit,duke e marrë parasysh aspektin legal, etik dhe human. Shkelja e të drejtave të pacientëve ka qenë evidente nga aspekti legal, derisa nga aspekti profesional dhe human është vepruar sipas protokollit për trajtim..

Metodologjia : janë marrë të dhëna nga historitë mjekësore për hospitalizimet e pavullnetshme dy vitet e fundit 2014-2015, janë shikuar urdhëresat e gjykatave pastaj statusi social ,grupmoshat dhe gjinia . Përmes metodes deskriptive dhe komparative janë arritë disa përfundime lidhur me hospitalizimet e pavullnetshme.

Rezultati : vetëm rreth 27% e hospitalizimeve të pavullnetshme në periudhen 2014-2015, janë bërë me urdhëresë të gjykatës. Rreth 62.5% të këtyre hospitalizimeve janë më çrregullime kronike psikotike , pastaj 7 % me çrregullime bipolare etj. Aspekti gjinor ; 34 % ishin femra ndërsa 66% meshkuj. Numrin më të madh e paraqet grupmosha nga 30 deri 49 vjeq prej 312 klient ose 62.3 %.

Përfundimi : gjatë asaj perudhe kohore ka munguar komunikimi me gjykatat , sa i përket trajtimit të pavullnetshëm. Ligji për Shëndet Mendorë obligon marrjen e miratimit nga gjykata për trajtim të pavullnetshëm , por edhe të marrjen e miratimit të klientit për trajtim të vullnetshëm.

Fjalët kyqe : hospitalizim, i pavullnetshëm, klient.

INVOLUNTARY HOSPITALIZATION - THE ETHICAL, LEGAL AND HUMANE ASPECTS

Sh.Mecinaj, O.Veliu ,H.Fazliu, V.Tafilaj,B.Kadriu, L.Halili

Abstract: Every year in the Department of Psychiatry, there are hospitalized 250 clients, involuntarily. Psycho-pathological manifestations, court orders and other circumstances "compel" physician of the admission office to make decisions on involuntary hospitalization.

Aim: The aim of this study is to see how the hospitalization done regarding the treatment of involuntary clients until the end of 2015, when the Law on Mental Health adopted. In addition, the challenges related to the beginning of the implementation of the Law, taking into consideration the legal ethical and human aspects. The implementation of the law, seen in the light of recommendations from the Commission of the European Council and other relevant factors. From the legal aspect, the violation of the rights of patients has been evident, while the professional and human aspect of the treatment conducted according to medical guidelines and the best practices of the Psychiatric Department.

Methods: The data obtained from the medical files of the involuntary hospitalizations of cases during last two years (2014-2015) and court orders. The data about the social status, age groups and gender was taken into consideration. Through descriptive and comparative method are reached conclusions about the involuntary hospitalization.

The result: 27% of involuntary hospitalizations during the period of 2014-2015 were made by order of the court. Around 62.5% of these hospitalizations were patients with chronic psychotic disorders, 7% with bipolar disorders etc. Gender; 34% were female and 66% male. Largest number of patients represents the age group of 30 to 49 years old (312 clients or 62.3%). In these cases the court has not directly requested any opinion for treatment from the Psychiatric Department.

The conclusion: during that time period there was the lack of communication with the courts in terms of involuntary treatment. Kosovo Law on Mental Health requires obtaining approval from the court for involuntary treatment, but also of obtaining client approval for voluntary treatment.

Key words: hospitalization, involuntary, client

